



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2015
Nr. Dok. 201401669/6

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave sa më parë të jetë e mundur për trajtimin me tokë bujqësore të familjeve të Fshatit Fajzë, Rrethit Has, sikundër përcaktuar në VKM nr.716, datë 18.12.1995, ndryshuar me VKM nr.531, datë 18.12.1997.*

Drejtuar : **Z.Sadi Vorpsi**
Prefekt i Qarkut,

TIRANE

Për dijëni : **Z.Niko Peleshi**
Zv.Kryeministër i Republikës së Shqipërisë,
Kryetar i Komisionit Qeveritar të Tokës,

TIRANE

I nderuar z. Vorpsi!

Sikurse jeni në dijëni, Institucioni i Avokatit të Popullit ka në proces shqyrtimi prej muajit Shtator 2014, çështjen e prezantuar prej familjeve të Fshatit Fajzë, Rrethi Has, për mostrajtimin e tyre me tokë bujqësore sikundër përcaktuar në VKM nr. 716, datë 18.12.1995, "Për sistemimin e familjeve të Fshatit Fajzë, të Rrethit Has në tokat disponibël të kurorës së Tiranës", ndryshuar me VKM nr.531, datë 27.01.1997, "Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.716, datë 18.12.1995".

Në përgjigje të kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit, nr.K3/I58-2 prot, datë 13.10.2014, përsëritur me Shkresën nr. K3/I58-2 prot, datë 13.10.2014, ju z.Prefekt, në shkresën nr.270/1 prot, datë 21.01.2015, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, keni kërkuar mundësimin e zhvillimit të një takimi lidhur me këtë çështje. Në takimin e zhvilluar në nivel specialistësh, përfaqësuesit tuaj, u shprehën se, Prefektura e Qarkut, Tiranë, nuk disponon ndonjë dosje rreth kësaj çështjeje dhe se i jeni drejtuar Ministrisë së Transporteve dhe Infrastrukturës, për vënien në dispozicion të akteve të administruar prej saj për këtë çështje.

Përkundër kësaj situate të prezantuar, Institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar me Shkresën nr.K3/I58-4 prot, datë 06.03.2015, Drejtorisë së Shpronësimeve, pranë

Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, për dhënie informacioni rreth veprimeve të kryera për zgjidhjen e çështjes së familjeve të përmendura në VKM nr.716, datë 18.12.1995, të ndryshuar. Në përgjigje të kërkesës, Sekretari i Përgjithshëm pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me Shkresën nr.1646/1 prot, datë 25.03.2015, konfirmon faktin e moskompetencës së Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës, në trajtimin e kësaj çështjeje.

Pra, edhe pse kanë kaluar më shumë se 17 vjet nga dalja e VKM nr.716, datë 18.12.1995, të ndryshuar, 116 familjeve të Fshatit, Fajzë të Rrethit Has, ende nuk ju është mundësuar e drejta e përfitimit të tokës bujqësore, sikurse përcaktuar në këtë Vendim.

Rezulton sipas VKM nr. 716, datë 18.12.1995, se është miratuar lëvizja nga Fshati Fajzë, Rrethi Has, për në Kurorën e Tiranës, Rrethit Tiranë, i 116 familjeve, sipas listës bashkëlidhur Vendimit, dhe se Këshilli i Rrethit, Tiranë, ngarkohet me detyrimin e ndarjes së 215 ha tokë të refuzuara nga banorët e Fshatit Damjan, brenda datës 31.03.1996. Prefektura e Tiranës, sipas pikës 4, të VKM-ës në fjalë, ngarkohet me detyrimin e ndjekjes dhe kontrollit në zbatimin e këtij vendimi.

Referuar VKM nr.716, datë 18.12.1995, vendosja e 116 familjeve në Kurorën e Tiranës, sipas Vendimit të lartpërmendur të Këshillit të Ministrave, nuk ka ndodhur për shkak të ndryshimit të pikës 1 të saj me VKM nr.531, datë 27.01.1997 *“Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave Pika 1 e VKM nr. 716, datë 18.12.1995”*, të ndryshuar, Sipas ndryshimit të kryer sistemimi me troje ndërtimi i 116 familjeve të Fshatit Fajzë, Rrethi Has, do të kryhet në Fshatin Çekrezë, Komuna Zall-Herr, në Rrethin Tiranë, sipas studimit të miratuar nga Këshilli i Regullimit të Teritorit:.

Nga nga ana e familjarëve deklarohet se, Komuna Damjan, Tiranë, ka refuzuar të trajtojë me tokë bujqësore të 116 familjet e përcaktuara në VKM nr.716, datë 18.12.1995, dhe se organi i Prefekturës, Tiranë, nuk ka mundësuar ndjekjen dhe kontrollin në zbatimin e këtij vendimi. Për këtë çështje, në mënyrë vazhduese, është kërkuar dhe kërkohet nga ana e subjekteve të përcaktuar në listen që i bashkëlidhet Vendimit nr.716, datë 18.12.1995, mundësimi i trajtimit me tokë bujqësore sikundër vendosur, por deri më sot, pa shkak, ju është mohuar dhe ju mohohet e drejta e vendosur nga Këshilli i Ministrave.

Në këtë situatë, 116 familjet Fshatit Fajzë, Rrethi Has, janë gjendur dhe gjenden në pamundësi për sigurimin e mjeteve për jetesën dinjitoze të anëtarëve të çdonjerës familje, kjo për faktin se, organe të caktuara të administrates, ku përfshihet dhe Prefektura, Tiranë, kanë neglizhuar dhe neglizhojnë marrjen e masave përkatës për zbatimin e VKM nr.716, datë 18.12.1995, *“Për sistemimin e familjeve të Fshatit Fajzë, Rrethi Has, në tokat disponibël të Kurorës së Tiranës”*, të ndryshuar, në afatin e vendosur.

Funksionimi i organeve të ngarkuara për zbatimin, ndjekjen dhe kontrollin e këtij vendimi në fjalë, konstatohet se, nuk vjen në respektim të parimit të ligjshmërisë, parimit të mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave të personave private, të parashikuara në nenin 9 dhe 10 të Kodit të Procedurës Administrative dhe detyrueshme në kuptim dhe zbatim të nenit 1 të këtij Kodi.

Qëndrimin e derisotëm të mbajtur prej organeve të caktuara për zbatimin, ndjekjen dhe kontrollin e VKM nr.716, datë 18.12.1995, e vlerësojmë në cënim të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës, nenin 6/1 të Konvetës Europiane e të Drejtave të Njeriut (miratuar me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996) e detyrueshme për respektim, si rrjedhojë e mosmarrjes së masave në afatin e vendosur për zbatimin e kësaj VKM-je.

Për arsyet e bërë me dije në këtë shkresë, Institucioni i Avokatit të Popullit bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin thuhet se : “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike*”, si dhe nenit 21/b, se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen*”.

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave të menjëhershme për mundësimin e zbatimit, ndjekjes dhe kontrollit të VKM nr.716, datë 18.12.1995, “Për sistemimin e familjeve të Fshatit Fajzë, Rrethi Has, në tokat disponibël të Kurorës së Tiranës”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Me besim në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERE

Etilda GJONAJ(SALIU)

**Konceptoi dhe Daktilografoi
A.Gjoleka**